



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT QË NDRYSHON MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN,
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN”**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 12.11.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin *“Për Ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian”*

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Drejtësisë.

1. Qëllimi i projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të BE-së.

Programi i Drejtësisë i BE-së është krijuar me Rregulloren (BE) Nr.1382/2013 të Parlamentit European dhe Këshillit të datës 17 Dhjetor 2013. **Objektivi i përgjithshëm i Programit** është të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të një zone europiane të drejtësisë, e bazuar në njohjen e ndërsjellë dhe besimin e reciprok, në veçanti, përmes nxitjes së bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale.

Programi parashikon 4 objektiva specifik:

- Lehtësimin dhe mbështetjen e **bashkëpunimit gjyqësor** në çështjet civile e penale;
- Mbështetjen dhe nxitjen e **trajnitimit gjyqësor**, duke përfshirë trajnimin gjuhësor për terminologjinë juridike, me qëllim nxitjen e një kulture të përbashkët ligjore dhe gjyqësore;
- Lehtësimin e **aksesit në drejtësi për të gjithë**, duke përfshirë nxitjen dhe mbështetjen e të drejtave të viktimave të krimit si dhe duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e mbrojtjes.

- d) **Mbështetjen e iniciativave në fushën e politikës së lëndëve narkotike**, në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor dhe parandalimin e krimit, aspektet që lidhen ngushtë me objektivin e përgjithshëm të programit, në masën që nuk mbulohen nga Fondi i Sigurisë së Brendshme për mbështetje financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftimin e krimit dhe menaxhimin e krizës, ose nga Programi për Shëndetin në Rritje.

Shqipëria merr pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet siç përcaktohen në Rregulloren (BE) Nr.1382/2013. Shqipëria merr tashmë pjesë në aktivitetet e Programit të drejtësisë së BE-së që lidhen me tre objektivat e parë të programit: a) bashkëpunimin gjyqësor, b) trajnimin gjyqësor dhe c) aksesin në drejtësi.

Memorandumi i mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së BE-së është ratifikuar me ligjin nr.11/2017, datë 2.2.2017 dhe përfshin tre objektivat e parë të programit (bashkëpunimin gjyqësor, trajnimin gjyqësor dhe aksesin në drejtësi) që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që nuk përfshin objektivin e katërt që lidhet me luftën kundër lëndëve narkotike.

Pas ratifikimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në vitin 2017, Komisioni European propozoi ndryshimin e tij, me qëllim përfshirjen e Shqipërisë edhe në objektivin e katërt të programit të Drejtësisë së BE-së që lidhet me lëndët narkotike. Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar nga palët në datën 12 shkurt 2018.

Ky ndryshim i memorandumit të mirëkuptimit synon të zgjerojë objektin e tij, duke përfshirë në fushën e tij të veprimit edhe objektivin e katërt të programit të drejtësisë së BE-së lidhur me lëndët narkotike, i cili i përket fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu parashikohet ndryshimi i Aneksit 1 të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me kontributin financiar që duhet paguar nga Shqipëria në buxhetin e BE-së për të marrë pjesë në Programin e Drejtësisë së BE-së.

Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e BE-së për të marrë pjesë në katër objektivat e Programit të Drejtësisë së BE-së (a) bashkëpunimi gjyqësor, b) trajnimi gjyqësor, c) aksesin në drejtësi dhe **d) nismat lidhur me lëndët narkotike**) të do të jetë si më poshtë:

- **Për vitin 2017** parashikohen **41 674 euro** (duke përfshirë **6000 euro për objektivin “d” lidhur me lëndët narkotike**, që i përket Ministrisë së Brendshme);
- **Për vitin 2018** parashikohen **43 260 euro** (duke përfshirë **6000 euro për objektivin “d” lidhur me lëndët narkotike**, që i përket Ministrisë së Brendshme);
- **Për vitin 2019** parashikohen **44 974 euro** (duke përfshirë **6000 euro për objektivin “d” lidhur me lëndët narkotike**, që i përket Ministrisë së Brendshme);
- **Për vitin 2020** parashikohen **46 662 euro** (duke përfshirë **6000 euro për objektivin “d” lidhur me lëndët narkotike**, që i përket Ministrisë së Brendshme).

2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me prioritetet e parashikuara në PKIE 2018 - 2020, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

[Type here]

3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së që lidhet me fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor:

- Legjislacioni parësor i BE-së:

Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): **Nenet 81** (ish-neni 65 i TKE), **82** (ish-neni 31 i TKE), **84**,
Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): **Nenet 1, 78**.

- Legjislacioni dytësor i BE-së:

Rregullorja (BE) Nr.1382/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 17 Dhjetor 2013 “Për krijimin e Programit të Drejtësisë për periudhën 2014-2020”.

Neni 81, pika 1 e TFBE-së parashikon se: “Bashkimi Europian zhvillon ***një bashkëpunim gjyqësor në çështjet civile*** me rrjedhoja ndërkufitare, mbështetur në parimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve si dhe vendimeve në çështjet jashtëgjyqësore. Një bashkëpunim i tillë, mund të përfshijë miratimin e masave për përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare”.

Neni 82, pika 1 e TFBE-së parashikon se: “***Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale*** në Bashkimin Europian mbështetet në parimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore dhe përfshin përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare në fushat e përmendura në paragrafin 2 të nenit 83¹”.

Neni 84 i TFBE-së parashikon se: “Parlamenti Europian dhe Këshilli sipas procedurës së zakonshme legjislative ***mund të vendosin masa për të nxitur dhe mbështetur veprimet e Shteteve Anëtare në fushën e parandalimit të kriminalitetit, duke përjashtuar çdo harmonizim të akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare***”.

Neni 1, pika 2 e MSA-së parashikon se një nga synimet e Asociimit që vendoset mes Shqipërisë dhe BE-së është mbështja e përpjekjeve të Shqipërisë ***për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës***.

Neni 78 i MSA-së “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, parashikon se: “***Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, Palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe zbatimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar***”.

Rregullorja (BE) Nr.1382/2013 krijon Programin e Drejtësisë së BE-së për periudhën 2014-2020. **Neni 7, pika 1, shkronja “c” e Rregullores** parashikon se **shtetet candidate për**

¹ Pika 2 e nenit 83 të TFBE-së parashikon miratimin e direktivave të cilat vendosin rregulla minimale lidhur me përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve në një fushë të kriminalitetit të caktuar në nenin 83, pika 1 të TFBE-së (krimet e rënda me dimension ndërkufitar).

anëtarësim në BE mund të marrin pjesë në program në përputhje me parimet e përgjithshme, termat dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrjen e atyre vendeve në programet e BE-së, të përcaktuara në **marrëveshjet përkatëse kuadër**, Vendimet e Këshillit të Asociimit ose marrëveshje të ngjashme.

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së² vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet e Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje parashikon se Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në disa Programe të Bashkimit Evropian, duke kontribuar financiarisht në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me programet specifike në të cilat merr pjesë. **Neni 5 i kësaj Marrëveshjeje** parashikon se rregullat dhe kushtet specifike për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në një program të veçantë të BE-së (siç është Programi i Drejtësisë i BE-së), përcaktohen me **marrëveshje, në formën e një memorandum mirëkuptimi**, ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë.

4. Përfundime

Projektligji “*Për Ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian*”, **nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.**

Pavarësisht kësaj, ky projektligj është në përputhje me:

- **Nenet 81, 82 dhe 84 të TFBE-së** që parashikojnë **bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile dhe penale me rrjedhoja ndërkufitare**, ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së,
- **Nenet 1 dhe 78 të MSA-së** që parashikojnë se **Shqipëria dhe BE-ja** në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, **i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet, në përgjithësi, si dhe administrimit të drejtësisë, fuqizimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimit të efikasitetit të tij dhe përmirësimit të funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit, në veçanti.**
- **Nenin 5 të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë** për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së, që parashikon se **rregullat dhe kushtet specifike për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një program të veçantë të BE-së** (siç është Programi i Drejtësisë i BE-së), përcaktohen me **marrëveshje, në formën e një memorandum mirëkuptimi**, ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë me shumicë votash

NËNKRYETARI

BLEDAR ÇUÇI

² Ratifikuar me ligjin Nr.9404, datë 19.05.2005 "*Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare*".